



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1755 prot.

Tiranë, më 10. 11. 2019

Lënda: Sugjerime mbi projekt-ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Drejtuar: Z. ULSI MANJA
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT.
KUVENDI I SHQIPËRISË

PËR DIJENI: Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR KUVENDI
KUVENDI I SHQIPËRISË

I nderuar Z. Manja,

Në vijim të kërkesës Tuaj, për të dhënë opinion në lidhje me projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua mbi këtë projekt-ligj, sugjeron si më poshtë:

- Në nenin 4 “Respektimi i të drejtave të njeriut”, pika 6 parashikohet se:

“Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuara u garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues i ndonjë lloji, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre.”

Propozojmë të riformulohet si më poshtë pika 6:

“Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuara u garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues i çdo forme, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh aksesueshmërinë, sipas standarteve dhe legjislacionit në fuqi që rregullon çështjet e aksesueshmërisë.

- Neni 6 titulli i nenit “*Trajtimi i diferencuar i të dënuarve*”, propozojme të përshtatet me “Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke u emërtuar “*Trajtimi i ndryshëm i përligjur*”.
- Në nenin 18 “*Regjimi i posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë*” pika 5 shkronja b) propozojmë të shtohet edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krahas Avokatit të Popullit si institucion, në menyrë që të lejohet i denuari ose i paraburgosuri për kryerjen e bisedave telefonike.

Formulimi i pikës 5 shkronja b) si më poshtë:

1. b) “*lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen e një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kurse, për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e kësaj shkronje nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut*”

- Në nenin 44 në vijim të pikës 2 propozojmë të shtohet një pikë e cila të parashikojë punësimin e personave me aftësi të kufizuar brenda burgut.

Pika 3 të formulohet si më poshtë:

3. “*Të paraburgosurit dhe të dënuarit që janë me aftësi të kufizuara, mund të vihen në punë duke i ofruar “një përshtatje të arsyeshme”, sipas llojit të punës ose duke e përdorur punën për qëllime terapeutike.*”.

- Në nenin 44 poshtë pikës 7 të shtohet pika 8 me përmbajtje si vijon:

7. “*Të burgosurit të cilët punojnë, përfshihen në sistemet e sigurimeve shoqërore*”.

- Në nenin 45 “Arsimimi”, pika 3 e cila parashikon se: “*Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të paraburgosurit dhe të dënuarve me moshë nën 25 vjeç*”, propozojmë të riformulohet duke përfshirë edhe gratë.

Formuli si më poshtë:

3. "Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të paraburgosurit dhe të dënuarve me moshë nën 25 vjeç dhe grave".

- Në nenin 49 " **Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni**" , pika 7 parashikon se: "Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson takime konfidenciale të të paraburgosurve dhe të dënuarve me anëtarët e komisionit mbikëqyrës, mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht, përfaqësuesin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të fëmijëve, grave, të rinjve, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi", **propozojmë që në këtë nen të shtohen edhe komisionerët e krijuar me ligje të posacme si garantues i të drejtave të njeriut.**

Formulimi i pikës 7 si më poshtë:

"Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson takime konfidenciale të të paraburgosurve dhe të dënuarve me anëtarët e komisionit mbikëqyrës, mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht, përfaqësuesin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, **Komisionerët e krijuar me ligj të posaçëm**, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të fëmijëve, grave, të rinjve, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi".

- Po në këtë nen në pikën 12 propozojmë të shtohet edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në mënyrë që mos të lejohet kontrolli i korrespondencës së të dënuarit as me vendim gjykate.

Formulimi i pikës 12 si më poshtë:

"Me kërkesë të prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, gjykata lejon kontrollin e korrespondencës të të dënuarit. Kontrolli mund të bëhet nga drejtori i institucionit ose nga persona të autorizuar prej tij në prani të prokurorit. Kërkesa e prokurorit pezullon dorëzimin e korrespondencës. Nuk lejohet kontrolli i korrespondencës mbi letrat që u dërgohen Avokatit të Popullit, **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, avokatëve mbrojtës dhe organizmave ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave të njeriut".

- Në nenin 51 " **Hyrja në Institucion**" propozojmë të shtohet edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucion që garanton mbrojtjen nga diskriminimi.

1. "Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese,


zëvendëskryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, deputetët, zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Inspektorët e tij**, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe avokatët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.”

- Në nenin 58 “Ankesat”, pika 1 propozojmë të shtohet edhe Komisioneri në institucionet ku të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të paraqesin ankesë ose kërkesë me shkrim ose me gojë kundrejt personelit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

1. Formulimi si më poshtë:

“Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtimisht me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe të huaja, prokurorit ose gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin, sipas nenit 51, të këtij ligji”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ROBERT GAJDA

KOMISIONERI

